

Vendim nr. 29 datë 14.02.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Elsa Toska, anëtarë, në datën 14.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 145, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 08.05.2023 oficerët e Policisë Gjyqësore kanë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë*) kryerjen nga disa shtetas të aktivitetit kriminal të shitblerjes së votës për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023, referim mbi të cilin është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal (*KP*). Në kuadër të këtij procedimi penal, me vendime të datës 08.05.2023 të kësaj prokurorie,

mbi kërkesat e Policisë Gjyqësore, është vendosur autorizimi i vëzhgimit dhe i regjistrimit të fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende publike ndaj disa shtetaseve, një ndër të cilët edhe shtetasi Dh.A.B., lejimi i përdorimit të metodës speciale të hetimit për veprimet simuluese, si dhe lejimi i vëzhgimit. Po në këtë datë, mes prokurorëve të grupit hetimor dhe shtetasit A.R. është nënshkruar marrëveshja për kryerjen e veprimeve simuluese, ndërsa me vendimin e datës 10.05.2023 të kësaj prokurorie është vendosur, ndër të tjera, regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende private i shtetasit A.R. dhe personave të tjerë të pranishëm me këtë shtetas, si dhe përgjimi ambiental për një periudhë 4-ditore.

2. Në datën 11.05.2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për vleftësimin e vendimit të lejimit të përgjimit ambiental në vende private, ligjshmëria e të cilit është vleftësuar nga gjykata me vendimin nr. 42, datë 12.05.2023. Ndaj këtij vendimi, pasi ka rënë në dijeni për të, shtetasi Dh.A.B. ka ushtruar ankim. Me vendimin e datës 29.05.2023 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*) si gjykatë kompetente. Kjo e fundit, me vendimin nr. 104, datë 10.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 12.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në fakt të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë). Për rekursin e kërkuarit, me vendimin nr. 00-2023-1531, datë 26.09.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin.

3. Ndërkohë, në kuadër të këtij procedimi penal, në datën 12.05.2023 është bërë arrestimi në flagrancë edhe i shtetasit Dh.A.B., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të KP-së. Me vendimin nr. 205, datë 13.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është pranuar kërkesa e prokurorit, duke u vendosur vleftësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë të këtij shtetasi, caktimi ndaj tij i masës së sigurimit personal shtrëngues “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), deklarimi i moskompetencës së kësaj gjykate për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimi i akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*). Mbi bazën e materialeve të përcjella, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 111 të vitit 2023 në ngarkim edhe të shtetasit Dh.A.B., si autor i dyshuar i veprës penale të përmendur më lart. Ndërkohë, me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës ndaj personit nën hetim Dh.A.B., vendim i cili është

miratuar me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ndërsa me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit.

4. Në datën 31.07.2023, shtetasi Dh.A.B. ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi kompjuterik”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 186/3, 186/a/2, 248 dhe 300 të KP-së. Në kallëzimin penal, të regjistruar me nr. 173, datë 01.08.2023 (*kallëzim penal nr. 173/2023*), ai ka pretenduar se pas njoftimit të akuzës dhe akteve të procedimit penal nr. 111/2023 ka konstatuar se në dosjen penale në ngarkim të tij ishin administruar dy dokumente të falsifikuara, konkretisht “Certifikatë elektronike e z. Dh.A.B., datë 12.05.2023” (*certifikatë elektronike*), sipas së cilës rezultonte “i dënuar”, si dhe shkresë nr. 6761 prot., datë 27.06.2023 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (*shkresë nr. 6761/2023*), përmes së cilës është dërguar fotokopje e protokollit të dorëzimit të materialeve në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, në rreshtin e fundit të të cilit, me një shkrim tërësisht të ndryshëm, është shënuar se në datën 11.05.2023, akti nr. 5138 i është dërguar Gjykatës Vlorë në orën 14:45. Sipas kallëzuesit, pavarësisht pretendimeve të tij, Prokuroria e Posaçme nuk ka regjistruar procedim penal dhe nuk ka konstatuar falsitetin e këtyre akteve, duke vepruar në shkelje të nenit 277 të KPP-së. Për më tepër, Prokuroria e Posaçme e ka orientuar mbrojtësin e tij të paraqesë kallëzim penal në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm, ndërkohë që bazuar në nenin 80 të KPP-së, hetimi i këtyre pretendimeve është kompetencë lëndore e Prokurorisë së Posaçme, duke qenë se bëhet fjalë për një procedim të lidhur, pasi dokumentet e pretenduara si të falsifikuara janë administruar në kuadër të hetimit penal kundër tij dhe ndodhen në fashikullin e procedimit penal nr. 111/2023. Po sipas kallëzuesit, falsiteti i shkresës nr. 6761/2023 nuk është konstatuar as nga Gjykata e Posaçme e Apelit në vendimin nr. 104, datë 10.07.2023, gjyqtari i së cilës ka vepruar në kundërshtim me detyrimet e nenit 300 të KP-së. Në këto kushte, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme në procedimin penal kundër tij kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit që ka dhënë vendimin nr. 104, datë 10.07.2023, ka kryer veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së, punonjësi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, që ka nënshkruar marrjen e certifikatës elektronike, ka kryer veprën penale “Falsifikimi kompjuterik”, të parashikuar nga neni 186/a/2 të KP-së, punonjësi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, që ka dërguar shkresën nr. 6761/2023, ka kryer veprën penale “Falsifikimi i

dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, ndërsa të gjitha subjektet që kanë përdorur dhe përdorin këto dy dokumente kanë kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Në kuadër të kallëzimit, shtetasi Dh.A.B. ka kërkuar njëkohësisht edhe kryerjen e një sërë veprimesh hetimore.

5. Me vendimin e datës 03.08.2023 Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. 173/2023, me arsyetimin se faktet e kallëzuara nuk përmbanin elemente të veprave penale të kallëzuara ose të ndonjë vepre tjetër penale dhe nuk provohej ekzistenca e ndonjë fakti penal, për rrjedhojë ndjekja penale nuk mund të fillonte.

6. Me vendimin nr. 340, datë 02.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur mospranimin e ankimit të shtetasit Dh.A.B. dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal. Kjo gjykatë ka vlerësuar se në rastin në shqyrtim mungonin indiciet e sakta dhe të rëndësishme, të cilat mund të krijonin të dhëna të mjaftueshme se ishin konsumuar elementet e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi ose ndonjë vepër tjetër penale dhe se dyshimet bazoheshin vetëm në pretendimet e tij, të cilat nuk harmonizoheshin ose lidheshin me ndonjë akt ose provë tjetër. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi Dh.A.B.

7. Me urdhrin e datës 20.10.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit, e përbërë nga një gjyqtar, ka caktuar datën 07.11.2023 për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, ndërsa me aktin “Njoftim”, të dalë në bazë dhe për zbatim të këtij urdhri, ka bërë me dijeni palët se do të merrte në shqyrtim kryesisht çështjen e pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) të neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar (*ligji nr. 95/2016*). Për këtë qëllim, në respektim të nenit 33, pika 1, të Kushtetutës dhe parimit të kontradiktoritetit, gjykata ka ftuar palët të parashtronin mendimin e tyre me shkrim, ndër të tjera, edhe për çështjen e kushtetutshmërisë së dispozitave në fjalë.

8. Ndërkohë që Prokuroria e Posaçme nuk ka paraqitur pretendime me shkrim, në prapësimet e tij të datës 25.10.2023 shtetasi Dh.A.B. ka pretenduar se zgjidhja e çështjes në shqyrtim nuk varej nga kontrolli i kushtetutshmërisë së normës. Po sipas këtij shtetasi, kompetencat e prokurorisë dhe të gjykatës së posaçme në rastin konkret nuk përcaktoheshin nga nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, por nga neni 9, pika 1, i tij, i cili parashikon kompetencën e gjykatës së posaçme për të shqyrtuar një çështje kur ajo ka lidhje me një çështje

tjetër që është në kompetencën primare të saj. Kallëzimi penal kishte lidhje me çështje në ngarkim të tij që po hetoheshin dhe gjykoheshin nga prokuroria dhe gjykatat e posaçme.

9. Në vijim, në datën 30.10.2023, shtetasi Dh.A.B. i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Apelit me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, me argumentin se ishte shprehur në lidhje me kërkesën e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, gjykim në të cilin, ashtu si edhe në atë konkret, pretendimet kishin të bënin me përdorimin e dokumenteve të falsifikuara në procedimin penal në ngarkim të tij, si dhe se u kishte kërkuar mendim me shkrim mbrojtësve, pa qenë këta të deleguar për përfaqësimin e tij në këtë gjykatë. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Posaçme të Apelit, i cili, me urdhrin nr. 10, datë 01.11.2023, ka vendosur rrëzimin e saj.

10. Më pas, shqyrtimi i çështjes ka vijuar dhe, me vendimin e datës 07.11.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit të ankimit të shtetasit Dh.A.B. ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për shfuqizimin e vendimit të datës 03.08.2023 të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, si të papajtueshme me Kushtetutën. Në datën 07.02.2024, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e gjykatës referuese

11. *Gjykata referuese*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

Për legjitimitimin:

11.1. Kërkesa plotëson kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për iniciimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës. Kështu, ajo ka identifikuar nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 si dispozitat e zbatueshme në zgjidhjen e çështjes konkrete. Arsyet që parashtrohen për antikushtetutshmërinë e këtyre dispozitave janë serioze dhe kanë të bëjnë me cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të paanshmërisë së gjykatës dhe kompetencën e organeve të parashikuara në Kushtetutë. Zgjidhja e çështjes për shqyrtim para saj nuk mund të bëhet në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues, pasi mungesa e kompetencës lëndore përbën parakusht për gjykimin e çështjes së themelit. Nuk

ekzistojnë dispozita të tjera të cilat mund të zbatohen prej saj në vend të dispozitave të kundërshtuara si antikushtetuese. Nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 përbëjnë *lex specialis* në raport me dispozitat e tjera të këtij ligji e dispozitat e KPP-së dhe janë të vetmet që normojnë çështjen e kompetencës së Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme.

Për themelin e pretendimeve:

11.2. Dispozitat e kundërshtuara cenojnë *parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi:

11.2.1. Përcaktojnë kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme për hetimin dhe gjykimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të tyre në lidhje me vepra penale që përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Neni 135, pika 2, i Kushtetutës ka përcaktuar kompetencën e gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të veprave penale të kryera nga një grup subjektesh të posaçme, ku nuk përfshihen prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe gjyqtarët e gjykatave të posaçme, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë një nga veprat penale të parashikuara në kompetencën lëndore të këtyre gjykatave. Heshtja e Kushtetutës në këtë drejtim nuk mund të konsiderohet harresë e kushtetutëbërësit, por është e qëllimshme. Subjektet e posaçme në këtë dispozitë kushtetuese janë përcaktuar në të njëjtën mënyrë edhe në nenin 75/a, shkronjat “c” dhe “ç”, të KPP-së. Po kështu, neni 135, pika 2, i Kushtetutës nuk ka përcaktuar një listë shteruese të veprave penale në kompetencë lëndore të gjykatave të posaçme, ndërsa shkronjat “a” dhe “b” të nenit 75/a të KPP-së kanë një përmbajtje më të gjerë se dispozita kushtetuese, çka është vlerësuar nga Gjykata në përputhje me diskrecionin e ligjvënësit dhe natyrën dinamike të legjislacionit penal në vendimin nr. 16, datë 27.06.2022 të saj.

11.2.2. Në çështjen për shqyrtim, veprat penale për të cilat është bërë kallëzim penal nuk përfshihen në sferën e veprave penale që gjykohen nga gjykatat e posaçme, sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe nenit 75/a, shkronjat “a” dhe “b” të KPP-së, çka bën që nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 të jenë në tejkalim të parashikimit kushtetues dhe në kundërshtim me nenin 148/dh, paragrafi 1, të Kushtetutës. Prokurorët e Prokurorisë së

Posaçme dhe gjyqtarët e gjykatave të posaçme do të hetohen dhe gjykohen nga prokuroria dhe gjykatat e posaçme vetëm në rast se kanë kryer veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, shkronjat “a” dhe “b”, të KPP-së dhe nuk mund të hetohen dhe gjykohen prej tyre nëse kanë konsumuar veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KPP-së.

11.2.3. Neni 80 i KPP-së ka përcaktuar kompetencën e prejardhur të gjykatave të posaçme në rastet e procedimeve të lidhura, ku kuptimi i veprave penale të lidhura është përcaktuar edhe në nenin 3, paragrafi 8, të ligjit nr. 95/2016. Faktet penale që ndodhin gjatë hetimit ose gjykimit të një personi nën hetim ose të pandehuri janë të pavarura nga fakti penal për të cilin ai po hetohet ose gjykohet dhe nuk mund të konsiderohen procedim i lidhur me çështjen në hetim ose gjykim, sipas nenit 9, paragrafi 1, i ligjit nr. 95/2016. Në interpretimin që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u ka bërë neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 në çështje të ngjashme, kushtetutshmëria e këtyre dispozitave nuk është trajtuar në masën dhe thellësinë e duhur. Edhe pse autoritare, interpretimet e Gjykatës së Lartë nuk mund t’u imponojnë gjykatave më të ulëta zbatimin e një norme që çmohet antikushtetuese.

11.3. *Parimin e gjykatës së paanshme*, në drejtim të aspekteve subjektive dhe objektive të paanshmërisë, për shkak të hetimit ose gjykimit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe gjyqtarëve të gjykatave të posaçme nga kolegët e tyre brenda të njëjtit institucion. Në rastet e veprave penale të kryera nga prokurorët dhe gjyqtarët e gjykatave të zakonshme, neni 78 i KPP-së ka përcaktuar shmangien e cenimit të paanshmërisë në shqyrtimin e çështjeve nga kolegët e tyre, përmes gjykimit të këtyre çështjeve nga gjykata me kompetencën lëndore që ndodhet në qendrën e rrethit tjetër më të afërt.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. *Për legjitimitimin e gjykatës referuese*

12. Nenet 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës parashikojnë se Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, kur gjyqtarët

gjatë gjykimit çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën. Në këtë rast ata nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka zhvilluar disa kritere kumulative për legjitimitimin e gjykatës referuese për inicimin e kontrollit incidental të normës ligjore për pajtueshmëri me Kushtetutën. Sipas tyre, gjykata referuese duhet që gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet pranë saj: (i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e gjykimit konkret; (ii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatë - pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; (iii) të parashtojë arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iv) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 27.06.2022; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të dërguar së bashku me vendimin për pezullimin e gjykimit të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se Prokuroria e Posaçme është vënë në lëvizje nga shtetasi Dh.A.B. përmes kallëzimit për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi kompjuterik”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, ndër të tjerë edhe nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme që kanë hetuar procedimin penal nr. 111/2023 në ngarkim të tij, si dhe nga gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit që ka dhënë vendimin nr. 104, datë 10.07.2023 në lidhje me vleftësimin e vendimit të prokurorit për lejimin e përgjimit ambiantal në vende private. Ndërkohë, procesi gjyqësor është vënë në lëvizje përmes ankimit të këtij shtetasi kundër vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e tij penal nr. 173/2023, ndërsa gjykata referuese përmes ankimit po të këtij shtetasi kundër vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, që ka vendosur rrëzimin e ankimit të tij ndaj vendimit të kësaj prokurorie. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata referuese, *sua sponte*, ka vlerësuar të marrë në shqyrtim çështjen e papajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, shkak për të cilin ka njoftuar edhe palët në gjykim, me qëllim që të paraqesin mendimin e tyre me shkrim në lidhje me këto dispozita. Prokuroria e Posaçme nuk ka paraqitur komente, ndërsa shtetasi Dh.A.B. ka prapësuar se zgjidhja e çështjes së tij nuk varej nga kontrolli i kushtetutshmërisë së atyre normave dhe se kompetenca e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatës së posaçme për shqyrtimin e çështjes përcaktohej nga neni 9, pika 1, i ligjit nr. 95/2016.

15. Neni 14 i ligjit nr. 95/2016, për të cilin është kërkuar kontrolli kushtetues nga gjykata referuese, është pjesë e kreut III të këtij ligji, i cili përmban dispozita që kanë të bëjnë

me organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme, ndërsa neni në fjalë rregullon “Përgjegjshmërinë”, duke parashikuar: “Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorët të Prokurorisë së Posaçme ose gjyqtarët të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”. Dispozita tjetër për të cilën është kërkuar kontrolli kushtetues nga gjykata referuese, neni 53 i këtij ligji, është pjesë e kreut VIII që përmban dispozita në lidhje me kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm, si dhe personelit të gjykatave të posaçme dhe të SPAK-ut, ndërsa neni në fjalë rregullon “Raportimin e informacionit dhe provave”, duke parashikuar: “1. Çdo person, përfshirë oficerët përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, kanë të drejtën të raportojnë informacion apo prova të një shkeljeje të kryer nga një kryetar ose gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokuror i Prokurorisë së Posaçme, drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer i shërbimeve të Policisë Gjyqësore ose pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose nga një punonjës te një prokuror i Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje. 2. Bazuar në një raport, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, një prokuror i Prokurorisë së Posaçme nis një hetim kundër kryetarit ose secilit gjyqtar të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit ose prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose punonjësve, pa kërkuar miratim nga ndonjë autoritet tjetër.”.

16. Në analizë të dispozitave të sipërpërmendura, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se neni 14 i ligjit nr. 95/2016 pohon përgjegjësinë penale të prokurorit dhe gjyqtarit të posaçëm dhe qenien e tyre subjekt të hetimit në rast dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e një vepre penale, ndërsa pika 1 e nenit 53 të këtij ligji ka përcaktuar të drejtën e çdo personi, përfshirë edhe oficerët përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe të Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (FIU), për të raportuar te një prokuror i posaçëm informacion ose prova të një shkeljeje të kryer nga prokurorët dhe gjyqtarët e posaçëm, drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore ose pozicione të tjera në BKH apo nga punonjësit e këtyre strukturave, shkelje e cila ka të bëjë me kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin në kuptim të këtij ligji dhe mbi të cilën ngrihet një dyshim i arsyeshëm për korrupsion apo veprimtari kriminale. Ndërkohë, pika 2 e nenit 53 të ligjit nr. 95/2016 ka përcaktuar nisjen e një hetimi nga prokurori i posaçëm bazuar në raportin sipas pikës 1 të këtij neni, pa qenë e nevojshme marrja e miratimit nga ndonjë autoritet tjetër.

17. Në këndvështrim të përmbajtjes të këtyre dispozitave, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se neni 53 i ligjit nr. 95/2016, që si qëllim ka raportimin e informacionit dhe të provave për një shkelje që ka të bëjë me kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin të kryera nga zyrtarët e gjykatave të posaçme dhe SPAK-ut, si dhe nisjen, mbi bazën e këtij raporti, të hetimit ndaj këtyre zyrtarëve, nuk lidhet me shqyrtimin e çështjes që po gjykohet nga gjyqtari *a quo*. Ndaj, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk do të ndalet në analizën e mëtejshme të kriterëve të legjitimitetit të gjykatës referuese për sa i përket kësaj dispozite, pasi dukshëm kjo dispozitë nuk përcakton kompetenca lëndore parësore ose kompetenca lëndore të tjera të gjykatave të posaçme.

18. Ndërkohë, për sa u përket parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të ndalet në analizën e kriterit të parë, nëse është identifikuar ligji që do të zbatohet për zgjidhjen e gjykimit konkret dhe nëse kontrolli kushtetues i dispozitës së kundërshtuar i pamundëson gjykatës referuese zgjidhjen e çështjes për shqyrtim para saj. Sikundër është theksuar më lart, kriteret e legjitimitetit janë kumulative, ndaj mjafton edhe mosplotësimi i njërit prej tyre që gjykata referuese të mos legjitimohet në kontrollin incidental të normës.

19. Në lidhje me këtë kriter, gjykata referuese ka vlerësuar se zgjidhja e çështjes për shqyrtim para saj nuk mund të bëhet në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues, pasi mungesa e kompetencës lëndore përbën parakusht për gjykimin e çështjes së themelit. Sipas saj, nuk ekzistojnë dispozita të tjera, të cilat mund të zbatohen në vend të dispozitave të kundërshtuara si antikushtetuese dhe neni 14 i ligjit nr. 95/2016 është i vetmi që normon çështjen e kompetencës së Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme. Gjykata referuese ka analizuar parashikimet e kësaj dispozite në drejtim të përcaktimit të kompetencës së saj lëndore për gjykimin e çështjes përkundrejt përmbajtjes së nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe nenit 75/a të KPP-së.

20. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në çështjen për shqyrtim përpara gjykatës referuese, kallëzimi penal i shtetasit Dh.A.B. për veprime a mosveprime të prokurorëve dhe/ose gjyqtarëve të posaçëm gjatë hetimit dhe/ose shqyrtimit të kërkesave procedurale në kuadër të procedimit penal të regjistruar ndaj tij, nuk rezulton të jetë trajtuar nga prokurori i Prokurorisë së Posaçme në bazë të parashikimit të nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, që përcakton përgjegjshmërinë e prokurorëve të posaçëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht prokurorët ose gjyqtarët e posaçëm kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre

penale, dhe kjo dispozitë nuk duket se përcakton kompetencën e gjykatave për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

21. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kompetenca e gjykatave të posaçme përcaktohet nga neni 135, pika 2, i Kushtetutës, sipas të cilit këto gjykata gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur. Nga ana tjetër, edhe neni 148, pika 4, i Kushtetutës ka përcaktuar se Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

22. Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se në jurisprudencën e saj për shqyrtimin e ndryshimeve në KP për veprën penale të korrupsionit dhe kompetencën e gjykatave të zakonshme në lidhje me të, Gjykata ka pranuar se neni 135, pika 2, i Kushtetutës përcakton juridiksionin e gjykatave të posaçme, brenda juridiksionit të përgjithshëm penal, vetëm për disa kategori veprash penale, dhe jo vetëm nuk përmban një ndalim të shprehur, por as nuk mund të interpretohet se ky juridiksion përjashton kompetencën e gjykatave të zakonshme për gjykimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin. Po sipas Gjykatës, është në diskrecionin e ligjvënësit që, duke pasur parasysh natyrën e secilës vepër penale të korrupsionit dhe marrëdhëniet juridike konkrete që synohen të mbrohen, të bëjë edhe kategorizimin e tyre, çka është në linjë edhe me qëllimin e kushtetutëbërësit (*shih vendimin nr. 16, datë 27.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafët 39 dhe 45*).

23. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, për të cilat bën fjalë neni 135, pika 2, i Kushtetutës, janë përcaktuar në nenin 75/a të KPP-së, i cili parashikon se gjykata e posaçme gjykon krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të KP-së (*shkronja "a"*),

si dhe çdo vepër penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të KP-së (*shkronja "b"*).

24. Ndërkohë, kreu II i ligjit nr. 95/2016 rregullon kompetencat dhe juridiksionin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (*nenet 8-10*), ndërsa dispozita e kundërshtuar nga gjykata referuese është pjesë e kreut III të këtij ligji që rregullon veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme (*nenet 11-27*). Kështu, sipas nenit 8 të ligjit nr. 95/2016, në kompetencën lëndore parësore të gjykatave të posaçme hyjnë veprat penale që parashikohen në nenin 75/a të KPP-së, përfshirë edhe në ato raste kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik apo zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit. Po ashtu, ky ligj, në nenin 9 të tij, ka përcaktuar edhe kompetencat e tjera lëndore të këtyre gjykatave, ndër to, në pikën 1 të tij, edhe për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji. Nga ana tjetër, përkufizimi i termit “vepra penale të lidhura me çështjen ose hetimin” jepet në nenin 3, pika 8, të ligjit, sipas të cilit ky term nënkupton çdo vepër penale që është kryer me qëllim përgatitjen, mbështetjen, mundësimin, fshehjen ose shmangien e zbulimit të një shkeljeje penale që është në kompetencën kryesore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë gjithashtu edhe çdo shkelje penale që pengon hetimin e çështjes, kanos dëshmitarët, viktimat, gjyqtarët, prokurorët, hetuesit ose punonjësit, apo shkatërron ose i bën provat të papërdorshme në mënyra të tjera.

25. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se gjykata referuese ka në shqyrtim çështjen e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi Dh.A.B. për kryerjen nga prokurorë dhe gjyqtar i posaçëm të veprave penale “Falsifikim i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 186, 248 dhe 300 të KP-së, gjatë hetimit të çështjes penale në ngarkim të tij për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të parashikuar nga neni 328 i KP-së, kompetente për shqyrtimin e së cilës, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, janë gjykatat e posaçme.

26. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kallëzimi penal i këtij shtetasi nuk është bërë për shkak të cilësive të posaçme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kallëzuar, por për shkak të veprimeve a mosveprimeve të tyre në lidhje me procesin penal në ngarkim të tij, çka përfshihet në kompetencën e gjykatave të posaçme, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 95/2016.

27. Si konkluzion, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se neni 14 i ligjit nr. 95/2016 i kundërshtuar si antikushtetues nuk përcakton kompetencën lëndore të gjykatës referuese, ndaj nuk e pengon atë në shqyrtimin e çështjes përpara saj. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se gjykata referuese nuk ka arritur të identifikojë ligjin e zbatueshëm dhe të përcaktojë lidhjen e drejtpërdrejtë reale dhe aktuale mes dispozitës të kundërshtuar si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes për shqyrtim para saj.

28. Bazuar në standardet e mësipërme, si edhe në shkaqet e paraqitura në kërkesën në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 nuk janë të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes që është për shqyrtim para gjykatës referuese dhe se ajo nuk ka arritur të përcaktojë lidhjen e drejtpërdrejtë mes dispozitave të kundërshtuara dhe zgjidhjes së çështjes që ndodhet për shqyrtim para saj.

29. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga gjykata referuese, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ato nuk kanë të bëjnë me nenin 14 të ligjit nr. 95/2016, të pretenduar si antikushtetues, për rrjedhojë nuk do të ndalet në analizën e tyre.

30. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se Gjykata e Posaçme e Apelit nuk plotëson kriteret e legjitimitit për inicimin e kontrollit incidental të normës.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të, në bazë të neneve 31, 31/a dhe 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “*Shfuqizimi i neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të mbajtur nga shumica e gjyqtarëve, pasi vlerësojmë se kërkesa nuk rezulton haptazi e pabazuar, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur kalimi i saj për shqyrtim në seancë plenare.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes, rezulton se në datën 12.05.2023 është bërë arrestimi në flagrancë edhe i shtetasit Dh.A.B., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të KP-së. Kërkesa e prokurorit për vleftësimin e ligjshmërisë së arrestimit në flagrancë të këtij shtetasi është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, duke u vendosur caktimi ndaj tij i masës së sigurimit personal shtrëngues “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Po kështu, kjo gjykatë ka vendosur deklarinimin e moskompetencës së saj për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë.

3. Mbi bazën e materialeve të përcjella, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 111 të vitit 2023 në ngarkim edhe të shtetasit Dh.A.B., si autor i dyshuar i veprës penale të lartpërmendur. Ndërkohë, me vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është vendosur vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit personal ndaj këtij shtetasi, çka është miratuar me vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ndërkohë që ky i fundit është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

4. Në datën 31.07.2023 shtetasi Dh.A.B. ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme, i cili është regjistruar me nr. 173, datë 01.08.2023, në të cilin ka pretenduar se, pas njoftimit të akuzës dhe akteve të procedimit penal nr. 111/2023, ka konstatuar se në dosjen penale në ngarkim të tij ishin administruar dy dokumente të falsifikuara, konkretisht “Certifikatë elektronike e z. Dh.A.B., datë 12.05.2023”, sipas së cilës rezultonte “i dënuar”, si dhe shkresë nr. 6761 prot., datë 27.06.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Sipas tij, pavarësisht pretendimeve të parashtruara, Prokuroria e Posaçme nuk ka regjistruar procedim penal dhe nuk ka konstatuar falsitetin e këtyre akteve, duke vepruar në shkelje të nenit 277 të KPP-së. Për më tepër, kjo prokurori e ka orientuar mbrojtësin e tij të paraqesë kallëzim penal në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm, ndërkohë që bazuar në

nenin 80 të KPP-së, hetimi i këtyre pretendimeve është kompetencë lëndore e Prokurorisë së Posaçme, duke qenë se bëhet fjalë për një procedim të lidhur, pasi dokumentet e pretenduara si të falsifikuara janë administruar në kuadër të hetimit penal kundër tij dhe ndodhen në fashikullin e procedimit penal nr. 111/2023. Po sipas këtij shtetasi, falsiteti i shkresës nr. 6761/2023 nuk është konstatuar as nga Gjykata e Posaçme e Apelit në vendimin nr. 104, datë 10.07.2023, gjyqtari i së cilës ka vepruar në kundërshtim me detyrimet e nenit 300 të KP-së. Në këto kushte, krahas veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Falsifikimi kompjuterik”, të kryera nga subjektet e tjera të kallëzuara, në procedimin penal kundër tij prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, ndërsa gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit që ka dhënë vendimin nr. 104, datë 10.07.2023, ka kryer veprën penale “Moskallëzimi i krimi”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së. Në kuadër të kallëzimit penal të bërë, shtetasi Dh.A.B. ka kërkuar njëkohësisht edhe kryerjen e një sërë veprimesh hetimore.

5. Me vendimin e datës 03.08.2023, Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal të shtetasit Dh.A.B., me arsyetimin se faktet e kallëzuara nuk përmbanin elemente të veprave penale të kallëzuara ose të ndonjë veprë tjetër penale dhe nuk provohej ekzistenca e ndonjë fakti penal, për rrjedhojë ndjekja penale nuk mund të fillonte. Me vendimin nr. 340, datë 02.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur mospranimin e ankimit të shtetasit Dh.A.B. dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal, për shkak se mungonin indiciet e sakta dhe të rëndësishme, të cilat mund të krijonin të dhëna të mjaftueshme se ishin konsumuar elementet e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi ose ndonjë vepër tjetër penale, dhe se dyshimet bazoheshin vetëm në pretendimet e tij, të cilat nuk harmonizoheshin ose lidheshin me ndonjë akt ose provë tjetër.

6. Gjatë shqyrtimit të ankimit të shtetasit Dh.A.B. ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, gjyqtari i çështjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit ka bërë me dije palët se do të merrte në shqyrtim kryesisht çështjen e pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe KEDNJ-në të neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 dhe, për këtë qëllim, në respektim të nenit 33, pika 1, të Kushtetutës dhe parimit të kontradiktoritetit, ka ftuar palët të parashtronin mendimin e tyre me shkrim, ndër të tjera, edhe për çështjen e kushtetutshmërisë së dispozitave në fjalë. Ndërkohë që Prokuroria e Posaçme nuk ka paraqitur pretendime me shkrim, shtetasi Dh.A.B. ka prapësuar se zgjidhja e çështjes në shqyrtim nuk varej nga kontrolli i kushtetutshmërisë së normës dhe se kompetencat e prokurorisë dhe të gjykatës së posaçme në

rastin konkret nuk përcaktoheshin nga nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, por nga neni 9, pika 1, i tij, i cili parashikon kompetencën e gjykatës së posaçme për të shqyrtuar një çështje kur ajo ka lidhje me një çështje tjetër që është në kompetencën primare të saj. Po sipas këtij shtetasi, kallëzimi penal kishte lidhje me çështje në ngarkim të tij që po hetoheshin dhe gjykoreshin nga prokuroria dhe gjykatat e posaçme.

7. Me vendimin e datës 07.11.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit (*gjykata referuese*) ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatë për shfuqizimin si antikushtetuese të neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016. Gjykata referuese ka vlerësuar se ajo legjitimohet në kërkesën e saj për nisjen e kontrollit incidental, pasi plotëson kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Po kështu, në lidhje me thelbin e pretendimeve, ka vlerësuar se dispozitat e kundërshtuara cenojnë parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi bien ndesh me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe parimin e gjykatës së paanshme, pasi përcaktojnë hetimin ose gjykimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe gjyqtarëve të gjykatave të posaçme nga kolegët e tyre, brenda të njëjtit institucion, ndërkohë që për veprat penale të kryera nga prokurorët dhe gjyqtarët e gjykatave të zakonshme, neni 78 i KPP-së ka përcaktuar shmangien e cenimit të paanshmërisë në shqyrtimin e çështjeve nga kolegët e tyre, përmes gjykimit të këtyre çështjeve nga gjykata me kompetencën lëndore që ndodhet në qendrën e rrethit tjetër më të afërt.

8. Në analizë të kriterëve të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me nisjen e kontrollit incidental të normës ligjore, shumica ka vlerësuar se gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkesën e saj, sipas objektit, pasi nuk plotëson kriterin e parë, atë të identifikimit të ligjit që do të zbatohet për zgjidhjen e gjykimit konkret përpara saj. Sipas shumicës, neni 53 i ligjit nr. 95/2016 nuk lidhet me shqyrtimin e çështjes që po gjykohet nga gjyqtari *a quo*, pasi kjo dispozitë ka si qëllim raportimin e informacionit dhe të provave për një shkelje që ka të bëjë me kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin të kryera nga zyrtarët e gjykatave të posaçme dhe SPAK-ut, si dhe nisjen, mbi bazën e këtij raporti, të hetimit ndaj këtyre zyrtarëve. Për rrjedhojë, sipas saj, neni 53 i ligjit nr. 95/2016 dukshëm nuk përcakton kompetenca lëndore parësore ose kompetenca lëndore të tjera të gjykatave të posaçme (*shih paragrafin 17 të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

9. Për sa i përket nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, shumica ka konstatuar se hetimi penal që qëndron në thelb të çështjes për shqyrtim para gjykatës referuese nuk është iniciuar mbi bazën e këtij neni, i cili përcakton përgjegjshmërinë e prokurorëve të posaçëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht prokurorët ose gjyqtarët e posaçëm kur kanë dyshime të arsyeshme për

kryerjen e një vepre penale, por mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit Dh.A.B. për veprime a mosveprime të prokurorëve dhe/ose gjyqtarëve të posaçëm gjatë hetimit dhe/ose shqyrtimit të kërkesave procedurale në kuadër të procedimit penal të regjistruar ndaj tij (*shih paragrafin 20 të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

10. Bazuar në parashikimet e neneve 135, pika 2 e 148, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në referim të jurisprudencës kushtetuese, shumica ka theksuar se neni 135, pika 2, i Kushtetutës përcakton juridiksionin e gjykatave të posaçme, brenda juridiksionit të përgjithshëm penal, vetëm për disa kategori veprash penale [...] dhe se është në diskrecionin e ligjvënësit që, duke pasur parasysh natyrën e secilës vepër penale të korrupsionit dhe marrëdhëniet juridike konkrete që synohen të mbrohen, të bëjë edhe kategorizimin e tyre, çka, sipas saj, është në linjë edhe me qëllimin e kushtetutëbërësit. Në vijim, në analizë të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016, që përcaktojnë kompetencën lëndore parësore dhe kompetencat e tjera lëndore të gjykatave të posaçme, si dhe të përkufizimit të shprehjes “Vepra penale të lidhura me çështjen ose hetimin” në nenin 3, pika 8, të ligjit nr. 95/2016, shumica ka vlerësuar se kallëzimi penal i shtetasit Dh.A.B nuk është bërë për shkak të cilësive të posaçme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kallëzuar, por për shkak të veprimeve a mosveprimeve të tyre në lidhje me procesin penal në ngarkim të tij, çka, sipas saj, përfshihet në kompetencën e gjykatave të posaçme, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 95/2016.

11. Në përfundim të analizës së saj, shumica ka konkluduar se edhe neni 14 i ligjit nr. 95/2016, i kundërshtuar si antikushtetues, nuk përcakton kompetencën lëndore të gjykatës referuese, për rrjedhojë kjo e fundit nuk ka pengesë në gjykimin e çështjes për shqyrtim para saj (*shih paragrafët 22-26 të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Në këto kushte, shumica ka vlerësuar të mos ndalet në analizën e pretendimeve të tjera të parashtruara nga gjykata referuese, duke vendosur përfundimisht moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Në ndryshim nga shumica, në rastin konkret vlerësojmë se çështja për shqyrtim para gjykatës referuese nuk mund të zgjidhej pa iu dhënë përgjigje nga Gjykata çështjes së kushtetutshmërisë së normave të kundërshtuara, pasi përcaktimi i saktë i kompetencës së gjykatës referuese, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, përbën parakusht për shqyrtimin e themelit të pretendimeve të ankimit të shtetasit Dh.A.B. Kjo për shkak se, në këndvështrimin kushtetues, kompetenca për gjykimin e çështjeve penale lidhet ngushtësisht me rrethin e akuzave të ngritura, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të ndryshme, në varësi të llojit të veprës penale.

13. Kështu, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, kushtetutëbërësi ka rishikuar përmbajtjen e nenit 135 të Kushtetutës, me qëllim parashikimin e rregullave bazë që bëjnë të mundur rikonceptimin e një sistemi gjyqësor efikas, profesional dhe të përgjegjshëm në një shtet të së drejtës. Duke shtuar në këtë nen pikat 2 dhe 4, që përmbajnë rregullime për gjykatat e posaçme, është synuar të parashikohet në nivel kushtetues dhe për herë të parë ngritja e një gjykate të re me juridiksion lëndor të posaçëm në fushën penale, e cila ka kompetencën të gjykojë disa kategori veprash penale brenda juridiksionit të përgjithshëm penal, konkretisht ato të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si edhe akuzat penale kundër një kategorie funksionarësh të lartë (*shih vendimin nr. 16, datë 27.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në jurisprudencën e saj në lidhje me kompetencën e organeve kushtetuese, Gjykata ka theksuar se Kushtetuta ka krijuar një sistem për ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, i cili i cakton secilit rolin e tij në strukturën institucionale shtetërore dhe në realizimin e detyrave që i janë besuar. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 41, datë 16.05.2017; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret theksojmë se krahas subjekteve të posaçme, specifikisht të përcaktuara, akuzat kundër të cilave shqyrtohen nga gjykatat e posaçme, neni 135, pika 2, i Kushtetutës ka përcaktuar edhe llojet e veprave penale që gjykohen nga këto gjykata, konkretisht veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Në lidhje me çështjen në shqyrtim, rezulton se gjykata referuese po gjykon ankimin e shtetasit Dh.A.B. ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë që ka vendosur rrëzimin e ankimit të tij ndaj vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal ndaj kallëzimit të këtij shtetasi për kryerjen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe gjyqtari i posaçëm të veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së. Qartazi, veprat penale për të cilat ky shtetas ka bërë kallëzim penal nuk përfshihen në sferën e llojit të veprave penale që, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, shqyrtohen nga gjykatat e posaçme.

16. Gjykata referuese ka vlerësuar se janë pikërisht dispozitat e kundërshtuara si antikushtetuese, konkretisht nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, të cilat përcaktojnë

juridiksionin e gjykatave të posaçme për të shqyrtuar edhe veprat penale për të cilat është bërë kallëzim nga shtetasi Dh.A.B.

17. Për sa u përket këtyre dispozitave, konstatojmë se neni 14 i ligjit nr. 95/2016 ka përcaktuar të drejtën e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme për të hetuar dhe ndjekur penalisht prokurorë të tjerë të kësaj prokurorie ose gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tyre të një vepre penale, duke përfshirë në këtë rregullim ligjor çfarëdolloj vepre penale të kryer nga këto subjekte, pa bërë dallim nëse bëhet fjalë për vepra penale kompetenca lëndore për shqyrtimin e të cilave i përket Prokurorisë së Posaçme ose gjykatave të posaçme për korrupsionin ose krimin e organizuar apo atyre që përfshihen në kompetencën lëndore të prokurorisë dhe gjykatave të zakonshme. Ndërsa neni 53 i këtij ligji ka përcaktuar të drejtën e prokurorëve të posaçëm që, mbi bazën e informacionit ose provave të raportuara nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të tij, të nisin hetimin penal kundër kryetarit ose secilit gjyqtar të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit ose prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose punonjësve, pa kërkuar miratim nga një autoritet tjetër.

18. Në rastin konkret, shumica ka vlerësuar se gjykata referuese nuk ka përcaktuar lidhjen e drejtpërdrejtë mes dispozitave të kundërshtuara dhe zgjidhjes së çështjes që ndodhet për shqyrtim para saj, pasi kompetencat dhe juridiksioni i institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar parashikohen në kreun II të ligjit nr. 95/2016 (*nenet 8-10*), ku neni 9, pika 1, përfshin edhe kompetencën për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër tjetër penale të lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, ndërkohë që dispozita e kundërshtuar nga gjykata referuese është pjesë e kreut III të këtij ligji që rregullon veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme (*nenet 11-27*) (*shih paragrafët 24 dhe 28 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

19. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se neni 8, pika 1, i ligjit nr. 95/2016 ka normuar kompetencën lëndore parësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila, sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, i Kushtetutës. Nga ana tjetër, ashtu siç edhe përcaktohet në nenin 9, pika 1, të ligjit nr. 95/2016, shprehja “çdo vepër tjetër penale që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale” ka të bëjë me ato vepra penale, të cilat përfshihen brenda kompetencës së gjykatave të posaçme, të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji, pra brenda kompetencave të

gjykatave të posaçme të përcaktuara nga neni 135, pika 2, i Kushtetutës. Në këtë kuptim, shprehja “çdo vepër tjetër penale që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale” në nenin 9, pika 1, të ligjit nr. 95/2016 nuk mund të interpretohet se përfshin edhe hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të lidhura që shqyrtohen nëpërmjet procedimeve të ndara, siç është rasti për shqyrtim para gjykatës referuese, por vetëm të atyre vepra penale të lidhura ngushtë me hetimin që shqyrtohen brenda të njëjtit procedim penal.

20. Në analizë të dispozitave ligjore të kontestuara përkundrejt parashikimeve të neneve 135, pika 2 dhe 148, pika 4, të Kushtetutës çmojmë se pavarësisht se normat objekt shqyrtimi nuk përcaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përderisa *prima facie* duket se përfshijnë në juridiksion të këtyre organeve edhe kompetenca të tjera, konkretisht hetimin dhe ndjekjen penale të prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm për veprat penale që hetohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Gjykata duhej të merrte në shqyrtim pretendimet e gjykatës referuese në lidhje me nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 për të përcaktuar nëse kompetencat e dhëna organeve të posaçme përmes këtyre dispozitave janë në përputhje me parashikimet kushtetuese. Në këtë këndvështrim, vlerësojmë se pretendimet e gjykatës referuese se këto dispozita cenojnë parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk rezultojnë haptazi të pabazuara. Për rrjedhojë, çmojmë se në rastin konkret duhej të ishte vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me qëllim që për antikushtetutshmërinë e pretenduar të neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 të dëgjoheshin edhe pretendimet e subjektit të interesuar, konkretisht të ligjvënësit.

21. Për sa më lart, në ndryshim nga shumica, çmojmë se *prima facie* pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk është haptazi i pabazuar dhe, si i tillë, kërkonte shqyrtim në themel në seancë plenare, në drejtim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së neneve 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 në lidhje me garancitë që ofron ky parim kushtetues.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim